



AGJENCIA KOMBËTARE
E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Nr. 1291 Prot.
Date, më 21.05.2025

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Nr. 236/1 Prot.

Tiranë, më 19.5.2025

Lënda: Për njohje dhe zbatim.

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓
Rr. "Aleksandër Moisiu", përballë IKV, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR
Rr. "Naim Frashëri", Tiranë


QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE
Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë

Bashkëlidhur, gjeni për njohje dhe zbatim vendimin nr. 249, datë 30.04.2025 të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 742, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP)"".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
Nr. 249 Prof.
Datë, më 30.04.2025

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 249, datë 30.4.2025

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.742, DATË 3.12.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E BAZËS
SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT
TË INFORMACIONIT PARAUNIVERSITAR (SMIP)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.742, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Të dhënat e bazës shtetërore të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat parësore të SMIP-së konsiderohen të dhënat e mbledhura nga QSHA-ja, që kanë të bëjnë me:

i. të dhënat e institucionit arsimor parauniversitar dhe institucionet e ofrimit të arsimit profesional, si:

- i.1. akti zyrtar për krijimin e institucionit;
- i.2. nivelet e arsimit parauniversitar/nivelet e arsimit profesional dhe drejtimet e profilet në arsimin profesional;
- i.3. shkolla vartëse (nëse ka);
- i.4. të dhënat për godinën;
- i.5. infrastruktura e shkollës.

- ii. të dhënat për kontratat e punës së mësuesve dhe nivelin e kualifikimit të tyre;
- iii. të dhënat për kurrikulat në arsimin parauniversitar/ skeletkurrikulat e arsimit profesional;
- iv. të dhënat për plotësimin e amzës digjitale;
- v. të dhënat për hartën sociale të nxënësve;
- vi. të dhënat për vlerësimin përshkrues për sjelljen, qëndrimin, njohuritë, shkathësitë e nxënësit në procesin mësimor edukativ gjatë gjithë vtitit shkollor.

b) Të dhënat dytësore të SMIP-së konsiderohen të dhënat që merren me ndërveprim nga:

i. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile:

- i.1. Numri i identifikimit personal;
- i.2. Emri, atësia, mbiemri;
- i.3. Datëlindja, vendlindja.

- ii. portali unik qeveritar “*e-Albania*”, për sa i përket “Kodit të shërbimit”;
- iii. sistemi i vlerësimit të maturës shtetërore, për sa i përket “Vlerësimit të provimeve të maturës”;
- iv. sistemi i provimeve të shtetit:

- iv.1. Rezultati i provimit të shtetit;
- iv.2. Profesioni/profilı.”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Dhënës të informacionit për SMIP-në janë institucionet arsimore parauniversitare, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, ministria përgjegjëse për arsimin, si dhe institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, si dhe institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional.”.

c) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Subjekte për sistemin SMIP janë institucionet arsimore parauniversitare, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, si dhe institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional.”.

ç) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Sistemi SMIP ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të regjistrat kombëtar të gjendjes civile me portalin unik qeveritar “e-Albania”, me sistemin “e-Matura” dhe sistemin e provimeve të shtetit (SPSH).”.

d) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Të dhënat që lidhen me dokumentacionin shkollor duhet të ruhen për aq kohë sa janë përcaktuar në aktet ligjore/nënligjore në fuqi.”.

dh) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Niveli i aksesimit në sistemin SMIP bazohet në rolet e krijuara të përdoruesve:

a) Ministria përgjegjëse për arsimin:

- i. shikon, modifikon institucionet dhe punonjësit në varësi;
- ii. shikon listën e nxënësve për shkollat në varësi;
- iii. gjeneron raporte dhe statistika.

b) Qendra e Shërbimeve Arsimore ka të drejta të plota në administrimin e sistemit;

c) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar:

- i. shikon, krijon, modifikon kurrikulën për arsimin parauniversitar;
- ii. shikon, krijon, modifikon lëndët mësimore dhe modulet kurrikulare;
- iii. kopjon/aktivizon kurrikulat për vitin shkollor pasardhës.

c) Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar:

- i. shikon institucionet në varësi;
- ii. shikon të dhënat e punonjësve në varësi;
- iii. gjeneron raporte dhe statistika për institucionet e punonjësit në varësi;
- iv. monitoron plotësimin e të dhënave nga shkollat në varësi sipas afatit kohor, të përcaktuar në aktet ligjore/nënligjore në fuqi.

d) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar:

- i. shikon dhe modifikon institucionet në varësi;
- ii. shikon, modifikon të dhënat e punonjësve në varësi;
- iii. gjeneron raporte dhe statistika për institucionet e punonjësit në varësi;
- iv. monitoron plotësimin e të dhënave nga shkollat në varësi.

dh) Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar:

- i. shikon, krijon dhe modifikon shkollat në varësi;
- ii. shikon, krijon, modifikon të dhënat e punonjësve në varësi;
- iii. shikon nxënësit e shkollave në varësi;
- iv. gjeneron raporte dhe statistika për institucionet e punonjësit në varësi;
- v. monitoron plotësimin e të dhënave nga shkollat në varësi;
- vi. implementon kurrikulën në nivel shkolle.

e) Ministria përgjegjëse për arsimin profesional:

- i. krijon, shikon, modifikon institucionet dhe punonjësit në varësi;
- ii. shikon listën e nxënësve për shkollat në varësi;
- iii. gjeneron raporte dhe statistika në nivel kombëtar për sistemin e arsimit dhe formimit profesional.

ë) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit:

- i. shikon, krijon, modifikon kurrikulën për arsimin profesional;
- ii. shikon, krijon, modifikon lëndët mësimore dhe modulet kurrikulare;
- iii. kopjon/aktivizon kurrikulat për vitin shkollor pasardhës.

f) Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive:

- i. shikon institucionet e arsimit profesional;
- ii. shikon punonjësit në varësi;
- iii. shikon listën e nxënësve për shkollat në varësi;
- iv. monitoron plotësimin e të dhënavë nga institucionet ofruese të arsimit profesional, sipas afatit kohor të përcaktuar në aktet ligjore/nënligjore në fuqi;
- v. gjeneron raporte dhe statistika për institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional.

g) Drejtori i shkollës:

- i. miraton ose refuzon transferimet, regjistrimet dhe rikthimin në shkollë të nxënësve;
- ii. shikon regjistrin për çdo klasë;
- iii. gjeneron vullën elektronike të shkollës;
- iv. gjeneron dëftesa dhe certifikata;
- v. gjeneron amzën digitale;
- vi. gjeneron raporte dhe statistika.

gj) Administratori i shkollës:

- i. shikon të dhënat e shkollës;
- ii. implementon kurrikulën në nivel klase;
- iii. gjeneron raporte dhe statistika;

- iv. shikon transferimet, regjistrimit dhe rikthimin në shkollë të nxënësve;
- v. shikon regjistrin për çdo klasë;
- vi. shikon ecurinë shkollore për vitin shkollor.

h) Mësuesi:

- i. shikon, modifikon, shton planin mësimor;
- ii. plotëson regjistrin për lëndën që jep mësim;
- iii. administron klasën në kujdestari;
- iv. plotëson hartën sociale për klasën në kujdestari;
- v. raporton të dhënat për vlerësimin.

i) Shërbimi psiko-social dhe oficeri i sigurisë:

- i. shohin nxënësit e shkollës/ave ku punojnë;
- ii. njoftojnë individualisht ose në grup për të gjithë nxënësit e klasës nëpërmjet SMIP-së, personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore me anë të “Fletores së komunikimit digjital” për t’i informuar ata në kohë reale për nxënësit, sipas detyrave dhe fushës së përgjegjësisë që mbulojnë.

j) Prindërit, të cilët shohin të dhënat e fëmijës të regjistruar në sistem si nxënës.”.

e) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Palët duhet të shkëmbejnë të dhëna personale në përputhje me qëllimin e grumbullimit të tyre, si dhe duhet të ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënavë bëhet në rrjet, si dhe nga çfarëdo forme tjeter e paligjshme përpunimi. Për çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigimin, përhapjen e të dhënavë etj., duhet të sigurohet gjurmueshmëria, me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënavë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Parauniversitar,

Kualifikimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I ARSIMIT
DHE SPORTIT

OGERTA MANASTIRLIU

NR.PROT. 2193/1
DATË 3.4.2025

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE
INOVACIONIT
QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE
AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR
AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT
PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

Në mungesë dhe me porosi

Herald JONUZAJ

